

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Hysnije Gashi, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.Sh.1 dhe M.B., për shkak të veprës penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I nr. 111/2013 të datës 05.12.2015, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shukri Jashari, të akuzuarit A.Sh.1 me mbrojtësin e tij av. A.S., të akuzuarit M.B. me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. M.H., i dëmtuari H.M. dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. M.K., pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 08/16/22.02.2016, 17/21.03.2016, të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli kurse me dt. 31.03.2016 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

A.SH.1 nga Kaçaniku, rr. “.....”, data e lindjes....., me numër personal, në të njëjtin vend, nga i ati E., e ëma S., e vajzërisë Sh., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, ish zyrtar i, filiali në Han të Elezit, tani i pa punë.

M.B. nga Prizreni, rr. “.....”, nr. ., data e lindjes....., në fsh., Komuna e Suharekës, nga i ati S., e ëma L., e vajzërisë B., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin juridik, në punës në agjencionin doganor “.....”, filiala në Han të Elezit, i gjendjes së mesme ekonomike.

I

I akuzuari A.Sh.1

Në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse gjatë muajit gusht – nëntor 2003 në filialën e me seli në Han të Elezit, në cilësinë e personit zyrtar – arkëtar, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka përvetësuar paratë e besuara në bazë të detyrës, në atë mënyrë që me rastin e deponimit të parave nga ana e të autorizuarit të të dëmtuarit H.M., djali i tij A.M., për pagesën e dy DUD-ave, dhe atë nr. 33949 të dt. 31.08.2003 në shumë prej 10.828.80€ dhe DUD-it nr. 48147 të dt. 03.11.2003 në shumë prej 10.228€, i pandehuri të njëjtat pagesa nuk i ka evidentuar në regjistrat e bankës për shlyerjen e detyrimeve doganore, për importin e mallit, por pagesat për këto dy DUD-a, i ka bërë nga kredia suazore e të dëmtuarit, me ç’rast i ka shkaktuar dëm të dëmtuarit në shumë prej 21.056.8€.

meqë nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së

Përfaqësuesi i të dëmtuarës “.....”, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

II

Ndaj të akuzuarit M.B.

Në bazë të nenit 363 par. 1 nënpar. 1.1 të KPP-së.

REFUZOHET AKUZA

Sepse gjatë periudhës kohore 2003-2004, në Han të Elezit, në cilësinë e personit përgjegjës në agjensionin “.....” në Han të Elezit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka përvetësuar paratë e besuara në bazë të detyrës së tyre, në atë mënyrë që ka bërë tërheqjen e parave me qëllim të pagesës së DUD-ave, mirëpo këto para nuk i kanë shfrytëzuar për pagesën e DUD-ave, por pagesa është bërë nga kredia suazore, e të dëmtuarit i shkaktajnë dëm në vlerë 74.089.73€

- meqë Prokurori i Shtetit është tërhequr nga aktakuza për veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr. 111/2015 të datës 05.12.2016, ndaj të akuzuarve A.Sh.1 dhe M.B., për shkak të veprës penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 22.12.2015, në të cilin shqyrtim të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm.

Gjykata caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 08/16/22.02.2016, 17/21.03.2016, kurse Prokurori i shtetit Shukri Jashari, ka bërë ndryshimin e aktakuzës duke u tërhequr nga aktakuza ndaj të akuzuarit M.B., kurse ka ndryshuar aktakuzën për të akuzuarin A.Sh.1 siç është përkthyer në versionin e këtij aktgjykimi, duke i propozuar Gjykatës, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi i paraparë me ligj.

2. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari A.Sh.1, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale dhe më tutje në mbrojtjen e tij ka pohuar se ka punuar në cilësinë e arkëtarit – në sportel të “.....” filiali Hani i Elezit, që nga viti 2002 deri në vitin 2013, në sportel, ka pranuar faktin se kanë pasur urdhër nga lartë, që klientët e tyre të cilët nuk kanë mjete t’u lëshojmë urdhërpagesa edhe pse nuk kanë pasur mjete pra nuk kanë bërë pagesën me që të njëjtit do të bënin pagesën në ditët në vijim me që banka menjëherë bënte pagesën e shumës siç ishte e shënuar në urdhërpagesë.

Më tutje i akuzuari në mbrojtjen e tij ka sqaruar çështjen e veresisë se firma e cila ka qenë dashur të paguaj doganën ka qenë e obliguar që të paraqitet në bankë dhe pastaj u ka lëshuar një urdhër për regjistrim për shumën edhe për numrin e DUD-it dhe këtë e ka

plotësuar me dorë dhe më pastaj ka pritur derisa kanë dalë mjetet në llogari duke përshkruar edhe numrin dhe shumën e DUD-it për pagesë dhe kur ka marrë këtë konfirmim që kanë dal mjetet në bankë për pagesë, atëherë ka lëshuar fletëpagesë me kompjuter, ashtu që urdhërpagesat e lëshuara me dorë kanë qenë funksionale vetëm derisa ka pritur deponimin në llogari, kurse për dallim prej këtyre pagesave ka sqaruar se tjetër mënyrë e pagesës ka qenë në rastet kur pagesa është bërë me para të gatshme meqë klientit menjëherë i është dhënë fletë deponimin elektronikë i nxjerrë nga sistemi. Kurse forma e pagesës pa mbulesë është kryer për firmën “.....”, por edhe për firma tjera dhe kjo formë është aplikuar nga banka për ti ruajtur klientët edhe pse kjo formë nuk ka qenë e rregullt por, ka qenë e imponuar nga zyrtarët e lartë të bankës.

3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 387 par. 1 dhe 2 të KPP-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akzuarit;
- nga dëgjimi i dëshmitarëve: H.M., A.M., I.L., B.B. dhe E.D.;
- nga shikimi dhe leximi në urdhrin për regjistrim dhe urdhërpagesa e dt. 17.03.2003;
- nga shikimi dhe leximi në urdhrin për regjistrim dhe urdhërpagesa e dt. 31.08.2004;
- nga shikimi dhe leximi në urdhrin për regjistrim dhe flete deponimi i dt. 01.10.2003;
- nga shikimi dhe leximi në fletë deponimi i dt. 07.10.2003;
- nga shikimi dhe leximi në urdhërpagesën e dt. 10.01.2004;
- nga shikimi dhe leximi në urdhërpagesa me nr. 109926;
- nga shikimi dhe leximi në fletë deponimi i dt. 10.04.2004;

- nga shikimi dhe leximi në urdhërpagesa 111255;
- nga leximi në fletë tërheqja e dt. 15.05.2004 dhe 07.05.2004;
- nga shikimi dhe leximi në urdhërpagesa me nr. 113984;
- nga shikimi dhe leximi në urdhërpagesa e dt. 03.12.2003;
- nga shikimi dhe leximi në pasqyra e qarkullimit të llogarisë e dt. 25.08.2004;
- nga leximi dhe shikimi në përgjigjen e bankës të dt. 17.03.2016;
- nga shikimi në analitiken e arkës të dt. 03.12.2003, 10.01.2004 dhe 06.04.2004 dhe atë për shifrën 127 dhe 128;
- nga leximi dhe shikimi në llogarinë bankare të të akuzuarit A.Sh.1 nr. nga dt. 01.01.2003 deri më dt. 16.03.2016;
- nga leximi dhe shikimi në llogaritë bankare për A.Sh.2, N.Sh., B.Sh. dhe M.R.;

4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Nga përmbajtja e dëshmisë së të dëmtuarit- dëshmitarit H.M. vërtetohet se ka qenë pronarë i biznesit N.T.P. “.....” me seli në Malishevë e cila është marrë kryesisht me shitjen e derivateve të naftës dhe atë nga viti 2000, se gjatë vitit 2003-2004 ka bërë importimin e malli, përkatësisht derivateve të naftës nga Maqedonia nga rafineria “.....” Shkup, e që zhdoganimin e derivateve të naftës të cilat i ka importuar, e ka bërë përmes firmës “.....” me seli në Prizren, nuk i kujtohet fakti se në çfarë forme ka qenë e angazhuar kjo kompani për zhdoganimin e mallit. Më tutje dëshmitari ka shtuar faktin se personalisht asnjëherë nuk është marrë me pagesën e detyrimeve doganore, por, kjo është bërë nga djali tij A.M., i cili ka bërë pagesat, e ndonjëherë këto pagesa janë bërë edhe nga ana e shoferëve të kamionëve.

Dëshmitari nuk e mohon faktin se nga ka marrë një kredi suazore në shumë prej 150.000/njëqind e pesëdhjetë mijë/€, e cila kredi është marrë në korrik të vitit 2003, porse të holla të gatshme nga kjo kredi nuk ka marrë, por marrëveshja ka qenë që këto mjete të përdoren në momentet e pagesave të faturave të ndryshme në rastet kur kompania nuk posedonte para të gatshme. Për më tepër ka specifikuar faktin se në rastet kur ka arritur nafta në doganë, ka marrë njoftim nga shoferi i kamionit, pastaj i njëjti është paraqitur tek

shpediteri, me qëllim të zhdoganimit të naftës, për të vazhduar me pagesa në nga mjetet e kredisë suazore, e që sipas tij disa nga këto pagesa janë paguar nga dy herë, një herë përmes bankës përkatësisht nga kredia suazore dhe njëherë janë paguar nga djali i tij A.M., e që tërësisht nga këto pagesa është dëmtuar në shumë prej rreth 74.000€

Po thuajse dëshmi të ngjashme ka paraqitur edhe dëshmitari A.M., i cili gjithashtu ka konfirmuar faktin se ka ndihmuar babain e tij H.M. dhe në emër të firmës ka bërë pagesa në në Han të Elezit në rastet kur bankat kanë qenë të mbyllura, por nuk i kujtoheshin sakt se sa pagesa të tilla i ka bërë me para kesh por mund të jenë përafërsisht shtatë (7) deri në tetë (8) herë, kurse në vitin 2004 ka kuptuar se pagesat për obligimet doganore janë bërë dy herë dhe atë një herë me para të gatshme kesh të cilat pagesa i ka bërë personalisht, por ndonjëherë pagesat i ka bërë edhe shoferi i kamionit por se përveç kësaj pagese pagesa ishte bërë edhe përmes xhironlogarisë bankare të firmës “.....”, duke sqaruar se pas pagesës dëshminë e bankës e ka dorëzuar tek agjensioni doganor “.....”, e cila ka pasur autorizim të plotësojë, përkatësisht rregullojë dokumentacionin për pagesën e doganës dhe pasi që kishte dorëzuar fletëpagesën nuk kishte njohuri se çka kishte ndodhur pos faktit se nafta kishte shkuar në pompën e benzinës.

Dëshmitari më tutje ka konfirmuar faktin se nuk është nënshkrimi i tij në asnjërin fletëpagesë të prezantuar përkatësisht të pagesave të dt.07.10.2003, 01.10.2003 dhe 17.07.2003, por hollësisht ka përshkruar mënyrën e pagesës se urdhër regjistrim e ka marr në bankë pastaj nuk i ka dhënë shënime punëtorit të sportelit as për shumën, por i ka dhënë shënime për emrin e firmës dhe qëllimin e pagesës – për doganim, kurse tjera shënime nuk i ka dhënë e pasi që ka bërë pagesën, ka marr urdhër për regjistrimin të cilin asnjëherë nuk i ka nënshkruar dhe pastaj e ka dërguar tek punëtorët e shpedicionit.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve meqë dëshmitë e tyre janë mjaft komplekse dhe atë për faktin se dëshmitarët ishin personat që kishin paraqitur kallëzimin penal përkatësisht kishin denoncuar të pandehurit dhe logjikisht ishin mjaft subjektiv në dëshmitë e tyre dhe se kishin një motiv tejet të lartë që të pandehurit të shpallehin të fajshëm për shkak të procedurave kontestimore që janë në zhvillim e sipër mes tyre dhe-në, andaj dëshmitë e tyre janë tërësisht të pabesueshme përkitazi me rrethanën e pagesave të dyfishta për më tepër dëshmitarët e sidomos dëshmitari A.M. edhe pse vazhdimisht pretendonte se kishte bërë personalisht këto pagesa nuk arriti të argumentonte me asnjë fakt të vetëm.

Përmes dëshmisë së dëshmitarit I.L. është vërtetuar fakti se i njëjti ka punuar si mbikqyrës në në Kaçanik, e po ashtu edhe për sportelin në Han të Elezit ku kanë punuar A.Sh.1, Sh.K. dhe B.D.. Ka pasur njohuri për faktin se ka dhënë kredi suazore e që një kredi të tillë e kishe marr edhe H.M. dhe atë në vlerë prej 150 mijë euro, po ashtu ka pasur njohuri për faktin se niveli qendror i-së ka pasur një qëndrim që disa kompanive t'u lejohet pagesa e shërbimeve doganore pa paguar parat në dorë, por mjetet janë inkasuar e pastaj pas dy ose tri dite klienti të njëjtit i ka paguar përmes llogarisë, ashtu që pasi parat janë derdhur në llogarinë e klientit nga ana e bankës ku klienti ka marr kredinë përkatësisht nga filiali në Prizren, atëherë arkëtarit i bankës këto mjete i ka ekzekutuar duke bërë pagesën në doganë. Gjithashtu ka sqaruar se shkurtesa MQ, ka nënkuptuar marrëdhënie me qendrën, përkatësisht kur klienti nuk ka pasur fonde të mjaftueshme në xhirollogari atëherë kjo urdhërpagesë është realizuar përmes tërheqjes nga xhirollogaria e klientit dhe një dëshmi për këtë iu ka dërguar edhe arkëtarit me qëllim të barazimit të gjendjes.

Dëshmia e këtij dëshmitari ka qenë e plotë dhe objektive i njëjti ka përshkruar në mënyrë mjaft të hollësishme mënyrën e pagesave përmes kredisë suazore e për më tepër ka paraqitur të dhëna të rëndësishme përkitazi me raportin- “.....” por edhe me firma të tjera të cilat kanë qenë të favorizuara dhe në rastet kur nuk kanë pasur para në llogari bankare atëherë pagesa është bërë përmes marrëveshjeve me qendër (MQ) që ka nënkuptuar se pagesa nuk është realizuar menjëherë. Se dëshmia e tij ishte objektive vërtetohet edhe përmes urdhërpagesave të lëshuara të shkruara me inicialet MQ.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit B.B. vërtetohet se është pronar i firmës “.....” e formuar në vitin 1992 me veprimtari primare ofrimi i shërbimeve rreth export-import për palët e treta dhe në raport me Administratën Doganore, kurse kujton faktet se pronari i “.....” – H.M., ka kërkuar shërbime për zhdoganimin e derivateve të naftës, duke i dhënë edhe autorizim të përhershëm për kryerjen e shërbimeve doganore. Më tutje dëshmitari ka pohuar faktin se personalisht nuk ka bërë asnjë shërbim doganor për firmën “.....” dhe ka sqaruar se si funksionon shërbimi i ofruar nga ana e firmës së tij dhe duke përshkruar edhe mënyrën e pagesave. Më tutje ka pohuar faktin se ka pasur njohuri se disa firma mes tyre edhe “.....” kanë qenë të privilegjuara nga ana e-së me rastin e pagesave doganore përkatësisht edhe pse nuk kanë pasur para për pagesë të detyrimeve doganore megjithatë i është dhënë urdhërpagesa dhe më pastaj kanë paguar.

Sa i përket dëshmisë së këtij dëshmitari i njëjti ka paraqitur të dhëna të pa rëndësishme dhe tërësisht jo relevante meqë siç edhe vet pohon se personalisht nuk ishte marrë me pagesa të shërbimeve doganore pos faktit që shërbimet janë kryer nga firma e tij e shpedicionit e megjithatë këto fakte të prezantuara nuk ishin fare kontestuese meqë konfirmohen edhe përmes provave materiale (urdhërpagesat) ku shihen se janë të vulosura nga kjo firmë e shpedicionit.

Gjithashtu edhe dëshmitari E.D. ka vërtetuar faktin se punon në firmën “.....” që 15 vite si agjent doganor në pikën kufitare në Han të Elezit e njeh personin A.Sh.1 nga fakti ka punuar në – filiali në Han të Elezit dhe kanë kryer shërbime edhe kompanisë “.....” duke i ofruar shërbimet e shpedicionit, e cila firmë kryesisht është marrë me importimin e derivateve të naftës, kurse ka shpjeguar procedurat që i aplikojnë me rastin e futjes së mallit në doganë, shoferi i kamionit pasi ka dorëzuar dokumentacionin e paraqesin në doganë dhe marrin urdhërpagesën me të cilën shkojnë në bankë për të bërë pagesën dhe më pas janë kthyer në doganë duke e vërtetuar atë dokument dhe pastaj malli është liruar nga terminali doganor. Dëshmitari më tutje ka shpjeguar konkretisht për pagesën e DUD-it 48147 se kjo pagesë është bërë me transfer bankar edhe pse në urdhërpagesë është shënuar kesh megjithatë paratë janë tërhequr nga llogaria bankare përkatësisht se ka shkuar në bankën në Han të Elezit për të kryer pagesën në bankë ka qenë duke punuar A.Sh.1, i cili pas verifikimit nga punëtori i “.....” - B.D. në Kaçanik pagesa është kryer përmes llogarisë bankare të firmës “.....” janë paguar detyrimet doganore.

Po ashtu edhe ky dëshmitar ka paraqitur të dhëna të sakta dhe nuk kishte as edhe një rrethanë që të mos i besohet dëshmisë së tij, për më tepër konfirmoi se pagesa e DUD-it 48147 ishte bërë përes transferit bankar.

Provat materiale urdhri për regjistrim dhe urdhërpagesa e dt. 31.08.2004 dhe urdhërpagesa e dt. 03.12.2003, vërtetojnë faktin se janë proceduar nga i pandehuri A.Sh.1, por nuk konfirmojnë asnjë fakt për personin që ka bërë pagesat për këto shuma që vërtetohen përmes përgjigjes së bankës të vërtetuar sipas analitikës së bankës, kurse nga shikimi në llogarinë bankare të të akuzuarit A.Sh.1 nr. nga dt. 01.01.2003 deri më dt. 16.03.2016 vërteohet se edhe llogaria e të pandehurit është përdorur për pagesa zyrtare të klientëve. Kurse sa i përket llogarive bankare të A.Sh.2, N.Sh., B.Sh. dhe M.R., të njëjtat nuk kanë paraqitur ndonjë të dhënë të rëndësishme, andaj edhe nuk do të trajtohen më tutje.

Kurse përkitazi me provat materiale urdhri për regjistrim dhe urdhërpagesa e dt. 17.03.2003, urdhri për regjistrim dhe flete deponimi i dt. 01.10.2003, fletë deponimi i dt. 07.10.2003, urdhërpagesa e dt. 10.01.2004, urdhërpagesa me nr. 109926, fletë deponimi i dt. 10.04.2004, urdhërpagesa 111255, fletë tërheqja e dt. 15.05.2004 dhe 07.05.2004, urdhërpagesa me nr. 113984, këto prova nuk kanë paraqitur asnjë relevancë meqë është vërtetuar se janë lëshuar nga ana e arkatarit me shifër 127 Sh.K..(meqë procedura ndaj tij është pushuar gjatë procedurës hetimore)¹

Gjykata vlerëson se provat e lartshënuara janë të besueshme nga fakti se janë përpiluara nga ana e personave zyrtar dhe se këto prova janë në përputhje të plotë edhe nga dëshmitë e dëshmitarëve.

5.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Gjithsesi për të bërë një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha provave në një proces gjyqësor është e nevojshme të vlerësohet edhe mbrojtja e të akuzuarit e cila natyrisht asnjëherë nuk duhet të vlerësohet në mënyrë fragmentare nga provat tjera dhe po ashtu edhe nga fazat tjera të procedurës penale, e që gjithsesi është e natyrshme që në rastet e tilla kur bëhet fjalë për një veprë të kësaj natyre të rëndë është pak e besueshme që nga i akuzuari të arrihet diçka më tepër rreth shtjellimit të kësaj çështje.

Por, nga mbrojtja e tij shihet se ka mohuar kryerjen e kësaj veprë penale dhe atë në të gjitha fazat e procedurës penale se mbrojtja e tij është e përqendruar në sqarimin se pagesat e DUD-ave ishin bërë përmes llogarisë bankare dhe se pagesa të dyfishta nuk ishin bërë, por se duke sqaruar se pagesat ishin bërë edhe në rastet kur nuk kishte para në xhirollogari të kësaj firme duke pritur që pastaj deri sa paratë të arrinin në llogari dhe pastaj të procedohej me pagesa elektronike por gjithmonë në koordinim me zyrtarët e lartë të-së.

Gjykata vlerëson se mbrojtja e të akuzuarit ishte konsistente në të gjitha fazat e procedurës penale pa asnjë ndryshim dhe se karakterizohet me mbrojtje të logjikshme, të natyrshme, për më tepër mbrojtja e tij është në harmoni dhe e mbështetur me të gjitha provat tjera të prezantuara.

6. Vlerësimi i fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit

¹ Aktvendimi i dt.02.12.2015

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare ka potencuar ekskluzivisht faktet që nuk ishin kontestuese (se i akuzuari punonte arkatar në, se kishte bërë pagesën e dy urdhërpagesave për zhdoganimin e mallit).

Por, në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se i akuzuari është kryerës i kësaj vepre penale, por, shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të arsyeshëm.

Fokusi i fjalës përfundimtare mbështetet në “adutin kryesor” (urdhërpagesat e dy DUD-ave, dhe atë nr. 33949 të dt. 31.08.2003 në shumë prej 10.828.80€ dhe DUD-it nr. 48147 të dt. 03.11.2003 në shumë prej 10.228€, e që nuk është kontestuese se këto pagesa janë bërë nga ana e të akuzuarit)

Por në asnjë fakt Prokurori i Shtetit nuk ka arritur që të paraqes provë konkrete se dëshmitari A.M. ka bërë një herë pagesën me para të gatshme dhe pagesa e dytë është bërë përmes llogarisë bankare.

Mes tjerash Prokurori i Shtetit në fjalën e tij përfundimtare pohon edhe faktin që “*I pandehuri nuk ka arritur që Trupit Gjykses t’ia prezantoj marrëveshjen që ka pasur banka me “.....”, andaj konsiderojmë se pagesat për këto dy Dokumente Unike Doganore janë përvetësuar nga ana e të akuzuarit.*” E cila pjesë e fjalës përfundimtare tenton që barrën e provës ta zhvendos tek i pandehuri që është në kundërshtim të plotë me nenin 7 të KPP-së si dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që në mënyrë eksplicite përcakton që barra e provës bie në organin e akuzës, për më tepër në rastin konkret është e padiskutueshme se ekzistonte një marrëveshje në mes-së dhe “.....” (kontrata për kredi suazore nr. 2/5/528 e dt. 02.07.2003, për më tepër e përcaktuar me nenin 1 të kësaj kontrate se destinimi i kredisë ishte pikërisht për pagesën e doganës dhe pagesave të tjera). E në kuadër të kësaj që u tha me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i pandehuri ka përvetësuar shumat siç është përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze.

Prokurori në fjalën e tij përfundimtare gjithashtu pohon faktin se “*është konstatuar se edhe përkundër të dy pagesave të kryera nga ana e A.M. me para cash, po për të njëjtët DUD-a është bërë tërheqja nga llogaria e të dëmtuarit H.M.*”, megjithatë bazuar në të gjitha provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fakti se dëshmitari A.M. të ketë paguar para cash për zhdoganime të mallit në doganë, e për

më tepër kjo pjesë e fjalës përfundimtare është në kundërshtim të plotë edhe me vet provat materiale, përkatësisht nga urdhërpagesa e evidentuar me nr. 079110 që përshkruan në mes të tjerash edhe numrin e DUD-it për të cilin është paguar obligimi doganor nr. 33949 të dt. 31.08.2003 në shumë prej 10.818.00€ në asnjë vend nuk është konstatuar se pagesa është bërë me para cash e për më tepër nuk është përshkruar se pagesën e ka bërë dëshmitari A.M., e gjithashtu edhe sa i përket urdhërpagesës 094014 të dt. 03.12.2003, që përshkruan në mes të tjerash edhe numrin e DUD-it për të cilin është paguar obligimi doganor nr. 33949 të dt. 31.08.2003 në shumë prej 10.818.00€, se personi që ka bërë pagesën ka qenë personi E.D., për më tepër në fletëtërheqjen është përshkruar se “*bartja është bërë me konversion në kuadër të bankës – deponim*”, që përjashton kategorikisht që edhe këtë urdhërpagesë ta ketë kryer dëshmitari A.M..

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

7.Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Konform nenit 463 par.2 dhe 3 të KPP-së, Gjykata ka udhëzuar të dëmtuarin NTP “.....”, që realizimin e kërkesës pasurore –juridike mund ta realizoj në kontest civil.

Konform nenit 454 par.1 të KPP-ës, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Sa i përket pjesës së dytë të këtij aktgjykimi, përkatësisht pjesës refuzuese të saj, prokurori i shtetit para fjalës përfundimtare është tërhequr nga akuza ndaj M.B.t për veprën penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, andaj gjykata si rezultat i kësaj ka marrë aktgjykim refuzues.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA, me PKR.nr.209/2015**

**Sekretarja juridike,
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.